



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ROSKOVEC

DREJTORIA E POLITIKAVE EKONOMIKE DHE PROMOVIMIT TË BASHKISË

Nr. 1486 prot.

Roskovec, më 19.02.2026

PROJEKT- VENDIM

Nr. ____ .Datë 19.02 2026

“PËR

MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE DHE INDIVIDËVE, QË PËRFITOJNË
SUBVENCIONIN E QIRASË”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, neni 24 pika 2 dhe neni 54, gërma "k", date 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar; Ligjit nr.22/2018, "Për strehimin social", Neni 15 dhe 16; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.384, datë 12.06. 2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo program social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore".

Ju paraqesim për diskutim dhe miratim:

- 1.Miratimin e listes së përfituesve për programin”Suvencionim qiraje”2026-2027,sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi.
- 2.Për zbatim të këtij vendimi ngarkohet Komisioni i Strehimit,Drejtoria e Politikave Ekonomike dhe Promovimit të Bashkisë,Drejtoria e Planifikimit dhe zhvillimit të Territorit,Mjedisit dhe Pronës.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj!

Konceptoi:A.Profka

Miratoi:E.Kuqo

Konfirmon:D.Hoxha

Për Drejtorin Juridike:V.Zeqo

Sasia e ekzeplarëve të shtupur 3(tre)

KRYETAR
Majlinda Bufi

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSKRYETARI
Maksim Goga



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ROSKOVEC

Nr. 1426/1 prot.

Roskovec, më 19.02.2026

Lënda: Relacion mbi projekt-vendimin për miratimin e listës përfituese për programin “subvecionim i qirasë”

KËSHILLIT BASHKIAK ROSKOVEC

Këtu!

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Në zbatim të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 ”Për strehimin social”, i ndryshuar, Komisioni i strehimit, pasi shqyrtoi dokumentacionin administrativo-ligjor përkatës, në mbështetje të Ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar, neni 2, VKM nr.384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, VKM Nr.459 datë 3.7.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë dhe uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”, VKM nr.301, datë 15.04.2021, “Për normat e strehimit”, VKM nr. 362, datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, është bërë vlerësimi i kërkesave, duke ndjekur procedurat si vijon:

1. Aplikantët kanë dorëzuar dokumentacionin e plotë pranë Zyrës së Informacionit, brenda afateve të përcaktuara.
2. Kërkesat e paraqitura, së bashku me dokumentacionin përkatës, janë shqyrtuar nga Komisioni i Strehimit. Vlerësimi është kryer në përputhje me kriteret ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi për përfitimin nga programi i subvencionimit të qirasë.,
3. Pas përfundimit të procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit, Komisioni ka hartuar listën përfundimtare të përfituesve, e cila përfshin aplikantët që plotësojnë kriteret e përcaktuara për përfitim.

Bazuar në dokumentacionin përkatës të çdo aplikanti, dhe në aktet ligjore në fuqi për përcaktimin e masës së subvencionimit, komisioni dakordësoi dhe vendosi të propozoj, Këshillit të Bashkisë miratimin e listës së familjeve që përfitojnë subvencionin e qirasë së tregut të lirë dhe masën e subvencionit.

Bashkëlidhur tabela me emrat e familjeve përfituese.

përcaktimin e masës së subvencionimit, komisioni dakordësoi dhe vendosi të propozoj, Këshillit të Bashkisë miratimin e listës së familjeve që përfitojnë subvencionin e qirasë së tregut të lirë dhe masën e subvencionit.

Bashkëlidhur tabela me emrat e familjeve përfituese.

Sa më lart, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë të miratojë këtë projekt-vendim, për t'u ardhur në ndihmë familjeve të pastreha, që banojnë me qira dhe nuk mund të përballojnë me të ardhurat e tyre vlerat e qirasë mujore.

Komisioni i Strehimit:

Maksim Goga

Eneida Hoxha

Suela Çepele

Ronada Hoxha

Edlira Toro

Vjollca Zeqo

Enkeleda Kola

KRYETAR
Majlinda Buri

ME URDHËR DHE ME MUNGESË

ZVENDËSKRYETARI

Maksim Goga



Lista përfutuese për programin "Subvecionim qirasë"

Nr .	Emër Mbiemër (kryefamiljari)	Kategoria së cilës I përket, sipas nenit 16 të ligjit nr. 22/2018	Përbërja familjare	Struktura e apart.	Sipërfaqja a e apart.	Qiraja mes.e apart.në treg për strukturën që i takon familjes
1	Bajame Flamur Xhindi	Kryefamiljare e divorcuar me ngarkim fëmijë	5 anëtarë	1+1	44,49 m2	10000
2	Luan Aziz Hamzai	Anëtar i komunitetit Rom, Ne	4 anëtarë	2+1	72.7 m2	15000
3	Elson Pëllumb Bani	Familje e Re	4 anëtarë	2+1	100 m2	15000

Komisioni:

Maksim Goga

Eneida Hoxha

Suela Çepele

Enkeleda Kola

Vjollca Zeqo

Edlira Toro

Ronada Hoxha

K R Y E T A R
Majlinda Bufi

**NË MUNGESË DHE ME URDHËF
ZËVENDËSKRYETAR**

Maksim Goga